



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E MBROJTJES SË KONSUMATORIT

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale dhe ushqim për nevoja të Strehëzes Veterinare”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 33140000-3.

Vlera e Fondit Limit: 24,031,000 (njëzet e katër milion e tridhjetë e një mijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formulari i Ofertës, sipas Shtojces 1;

b. Lista e çmimeve të artikujve shtojca 2;

c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

ç. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 26, dhe të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP 1“. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2020, 2021, 2022) një vlerë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës objekt prokurimi, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 40, neni 43, pika 2, germa b) të V.K.M Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, V.K.M Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës objekt prokurimi, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar". Kjo procedurë është mbi kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

2.2.2 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do ti kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve të deklaruar si më lart.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe ligjin Nr.9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, germa d) dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar Autoritetin Kontraktor se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet

që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë si dëshmi vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 22000:2018 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të LPP, nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të sigurisë së ushqimor. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i

vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ky standard specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemeve të menaxhimit të sigurisë kërkesat e përgjithshme për zhvillimin, zbatimin dhe përmirësimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore të një kompanie. ISO 22000 janë të përfshira në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë në zinxhirin e furnizimit ushqimor, nga prodhimi primar, korrja dhe prodhimi i ushqimit për kafshë deri tek përpunimi, industri ushqimore, shitje me shumicë dhe pakicë, katering, magazinim dhe shpërndarje. Certifikimi është gjithashtu për bizneset që prodhojnë pajisje, materiale ambalazhimi, materiale pastrimi dhe dezinfektimi, aditivë dhe përbërës. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të sigurisë së ushqimore.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën/çertifikatat ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet disponoje Liçencë profesionale të shoqërisë (e vlefshme), ku te jete e specifikuar kategoria për prodhim apo tregtim të produkteve veterinare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat, profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë për Produktet Mjeksore Veterinare nëse është prodhues/ distributori i autorizuar ose tregëtues i autorizuar nga prodhuesi/ distributori i autorizuar i mallrave për artikujt për këtë objekt prokurimi. Në rast se ofertuesi nuk është prodhues/ distributori i autorizuar i mallrave duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/ distributori i autorizuar i mallrave dhe të vërtetohet lidhja midis tyre (ofertues-distributor-prodhues) duke paraqitur kontratë furnizimi ose letër angazhimi/ akt-marreveshje (ose ekuivalent), si dhe në cdo formë tjetër që verteton lidhjen ndërmjet palëve. Në rast se ofertuesi është distributori i autorizuar i mallrave duhet të paraqesë dokumentacionin perkates nga ku, të vërtetohet lidhja midis tyre (distributor-prodhues). Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si telefon, fax, email, website. Kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. *(Nëse dokumentacioni është në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit).*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose / distributori i autorizuar ose tregëtues i autorizuar nga prodhuesi, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Autorizimi i prodhuesit / distributori i autorizuar ose tregëtues i autorizuar nga prodhuesi është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e

mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të këtyre mallrave. Në këtë kontekst, referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmimeve nga prodhuesi për produktet e ofruara, e cila është vendosur në përputhje me Specifikimet Teknike të procedurës, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me cilësitë monitoruese të produkteve, dhe nevojës për garanci mbi treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë si pjesë të ofertës teknike mostrat që kërkohen të prokurohen, të përcaktuar në DST në përputhje me specifikimet teknike, si më poshtë:

a) Operatorët ekonomik detyrimisht duhet të paraqesin nga një mostër fizike për objektin që do të prokurohen në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistem (SPE). Mosparaqitja e mostrave, dorazi, në ditën e hapjes së ofertave është kusht s'kualifikues.

b) Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Autoritetit Kontraktor Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, me adrese: Rruga “Murat Toptani” 1001, Ndertesë 12, Kati 2, Tiranë.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të deklarojë me anë të një deklaratë se Medikamentet Veterinare janë të regjistruara në regjistrin zyrtar të Produkteve Mjekësore Veterinare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40, pika 5, gërma a), si dhe neni 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 85, pika 1 dhe pika 5 e Ligjit nr.10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat, lejet profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Ky kriter lidhet gjithashtu me cilësitë monitoruese të produkteve, dhe nevojës për garanci mbi treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet dhe konform detyrimin ligjor që kanë për regjistrimin e tyre. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se merr përsipër me anë të mjeteve të tij të bëjë furnizimin e mallit objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor me shpenzimet e tij.

Argumentim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se merr përsipër me anë të mjeteve të tij të bëjë furnizimin e mallit objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor me shpenzimet e tij.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vetdeklarim për garancinë (skadencën) e mallrave jo më pak se 1 vit, nga momenti i lëvrimit të tyre.

Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që mallrat objekt prokurimi janë të vlefshme dhe brenda garancisë që kenë efektin e duhur mjeksore gjatë përdorimit të tyre.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar nëse është në gjuhën shqipe duhet të paraqitet në origjinal ose kopje e noterizuar e njësuar me origjinalin. Nëse dokumenti është në gjuhë të huaj, duhet të paraqitet i përkthyer nga një përkthyes i licencuar, shoqëruar me vërtetim përkthimi nga Noteri, si dhe i noterizuar e njësuar kopja me origjinalin nga Noteri.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia	Periodha e dorëzimit
1	Ushqim me kokrra për qen endacakë	Kg	40,000	15 ditë
2	Tasa ushqimi metalikë, inoksi S dhe XL	Copë	1,000	15 ditë
3	Qafore antiparazitare me gjatësia 60-70 cm	Copë	2,000	15 ditë
4	Antiparazitar i jashtëm me përmbajtje fipronili me pika për trajtimin e qenve	pipetë	2,500	15 ditë
5	Lexues microchipi universal	Copë	4	15 ditë
6	Mikrochipa	Copë	1,000	15 ditë
7	Doreza një përdorim sterile	Palë	500	15 ditë
8	Doreza jo sterile një përdorim	Palë	1,000	15 ditë

9	Anestetikë ndërhyrje operative për qen me përmbajtje ketamine+atropine+xylazine ne nje flakon ose ne flakon vec e vec per secilin medicament ketamine, atropine, xylazine	ml	1,000	15 ditë
10	Dezinfektant për dezinfektimin e ambienteve	Litër	50	15 ditë

1. Ushqimi i Qenve:

- Të ketë përmbajtje ne vlera Proteinike, Yndyrna, Fibra, vitaminave të grupit A, D, E etj dhe mikro e makroelemente.
- Të jetë i paketuar me thase 15-20 kg.
- Skadenca të jetë mbi 18 muaj.
- Ambalazhi të jetë i përshtatshëm për ruajtjen e përmbajtjes së ushqimit dhe të mos demtohet nga lageshtia, drita apo faktorë të tjerë mjedisor.
- Të jetë i pajisur me certificate analize dhe veterinare.

2. Tasa ushqimi metalikë, inoksi S dhe XL

- Të jenë metalike, që mos të ndryshken.
- Të jenë inoksi dhe të madhësisë S dhe XL.

1. Qafore antiparazitare:

- Të garantoje mbi 4 muaj mbrojtjen e kafshëve nga ektoparazitet.
- Të parandaloje leshmanjozen.
- Të jetë efektive dhe në lagështi.

2. Antiparazitar i jashtëm me përmbajtje fipronili me pika për trajtimin e qenve.

3. Lexues microchipi universal

- Duhet të jenë me funksion universal, me garanci mbi një vit, të punoje me bateri dhe korent, të lexoje kodin deri ne 2 Km.

6. Mikrochipa

- Të ketë nr e serisë.
- Të aplikohet lehte nën lekuren e shpatulles.
- Të ketë madhesi 1-2 ml.
- Të jetë me material të pa ndryshkur dhe të mos shkaktoje infektim në trupin e kafshës.
- Të jenë te padukshëm.
- Të jenë aktiv vetëm kur aktivizohet, gjurmohet dhe kerkohet nga aparati.
- Të jenë të sigurtë mos te shkaktojne infeksion në momentin e injeksionit.
- Të kenë skadencë mbi 2 vite.

7. Doreza një përdorim sterile

-

8. Doreza jo sterile një përdorim

-

9. Anestetikë ndërhyrje operative për qen me përmbajtje ketamine+atropine+xylazine ne nje flakon ose ne flakon vec e vec per secilin medicament ketamine, atropine, xylazine.

- “Anestetikë ndërhyrje operative për qen me përmbajtje ketamine+atropine+xylazine ne nje flakon ose ne flakon vec e vec per secilin medicament ketamine, atropine, xylazine” sqarojme: Nese produkti ofrohet ne nje flakon me permbajtje ketamine+atropine+xylazine duhet jete ne flakon 30ml ose 50 ml dhe ne total te jete 1,000 ml, ndersa nese ofrohet me alternativen me flakon te ndare ketamine, atropine, xylazine duhet te jete ne raportin 667 ml ketamine, 250 ml xylazine dhe 83 (100) ml atropine.

10. Dezinfektant për dezinfektimin e ambienteve:

- Të jenë antimikrobik, antimykotik dhe me përmbajtje glutaraldehyde, dimethylbenzyl ammonium. Të mos jene koroziv, djeges dhe toksik të përdoret dhe kur kafshët të jenë brënda ambjentit.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për materiale veterinare. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti. Sa më sipër, specifikimet teknike, janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale dhe ushqim për nevoja të Strehëzes Veterinare”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.